



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112/02-4529

Datë: 21.03.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 86 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 65 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Planin e Personelit 2024 me numër PP00001707, pas kërkesës/pëlqimit me numër 01-610/04-4410 të datës 21.03.2024 nga nëpunësja **Fatmire Kasumi** dhe **udhëheqësi i drejtpërdrejt i nëpunëses**, nxjerr këtë:

### V E N D I M

1. Nëpunësja **Fatmire Kasumi**, e sistemuar në punë **mësimdhënëse mbështetëse** në kuadër të SHF “Kelmend Rizvanolli”, **transferohet** në pozitën e **mësimdhënëses së arsimit fillor** në të njëjtën shkollë.
2. Vendi i ri i punës është i të njëjtës kategori sikurse vendi i mëparshëm, **sipas koeficientit 5.6** (klasa E19 sipas Ligjit numër 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).
3. Nëpunësja fillon punën në pozitën e mësimdhënëses së arsimit fillor në SHF “Kelmend Rizvanolli” nga data **02.09.2024**.
4. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore brenda afateve ligjore duhet të bëjë përditësimet e nevojshme në kontratën e nëpunësit të shërbimit publik sipas nenit 82 paragrafi 3 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik.
5. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

### A r s y e t i m

Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 21.03.2024 ka pranuar kërkesën numër 01-610/04-4410 nga nëpunësja Fatmire Kasumi përmes të cilës kërkonte që ti mundësohet transferimi i përhershëm në pozitën e mësimdhënëses së arsimit fillor në SHF “Kelmend Rizvanolli”. Kërkesa e nëpunëses përmbante edhe pëlqimin nga udhëheqësi i drejtpërdrejt i nëpunëses.

Nëpunësi publik mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit publik. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit publik. Përgatitja profesionale e nëpunësit që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet. Transferimi i nëpunësit publik brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunësit publik. Arsyetimi i vendimit të transferimit të përhershëm në interes të institucionit, përmban vlerësimin se nëpunësi plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet. Ky vlerësim kryhet nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e institucionit ku nëpunësi është i punësuar.

Pas shqyrtimit të kërkesës së nëpunëses, Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë nevojat e kapaciteteve të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës dhe në përputhje me Planin e

Personelit 2024 me numër PP00001707 dhe pas vlerësimit nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përmes të cilës konfirmohet se nëpunësja i plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet sipas nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) numër 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm përmes diplomës bachelor numër 1058 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe diplomës master numër 914 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, vendosi që nëpunësen Fatmire Kasumi ta transferoj duke e ngarkuar me detyrat e mësimdhënësës së arsimit fillor në SHF “Kelmend Rizvanolli”.

Bazuar në atë që u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh prej ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa i adresohet Komisionit të Ankesave në Komunën e Gjakovës.

**Vendimi iu dorëzohet:**

- Nëpunëses Fatmire Kasumi
- SHF “Kelmend Rizvanolli”
- Drejtorisë për Arsim
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

**Ardian Gjini**  
  
**Kryetar i Komunës së Gjakovës**

